

18.08.2023  
Ora 11:08

## **RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.**

### **PJESËMARRJA :**

#### **KQZ:**

- **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ M. Koja, E. Dushallari**


**Parti Politike: S’ka prezent**

**OJQ: S’ka prezent**

**Znj. I. Nano:** Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 11. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator dhe zyrtarë të administratës së komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës se mbledhjes së sotme kemi për të shqyrtuar dy projektvendime. I pari, “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023” dhe projektvendimi tjetër “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjeshme vendore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e këtyre projektvendimeve, pyes kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të trajtuar. Kolegë?! Nuk ka! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimeve. Zonja Koja do t’ju lutesha për projektvendimin e parë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e projektaktit dhe relacionin, faleminderit!

**Znj. M. Koja:** E nderuar zonja Kryetare e Komisionit Rregullator, të nderuar anëtarë! Në bazë dhe në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me këtë projektvendim parashikohet që në zgjedhjet e pjeshme vendore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, të përdoren kamera regjistruese dhe monitorë, për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në çdo vend të numërimit të votave. Gjithashtu do të përdoren sistemet e transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga vendi i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Projektvendimi parashikon se përdorimi i kamerave regjistruese dhe sistemeve të transmetimit video në kohë reale, nga VNV në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale, të miratuara me akt normativ, nga Komisioni Rregullator. Nga sa më lart propozojmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Koja, fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë kemi diçka në parim për projektvendimin? Në fakt janë disa zgjedhje tashmë që ne vendosim si Komision Rregullator, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, përdorimin e paisjeve elektronike, siç janë kamerat në rastin konkret. Në projektvendimin tjetër kemi PEI-n. Ndërkohë për kamerat në qendrat e votimit kemi një akt më herët të miratuar.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

Atëherë, nëse nuk kemi diçka në parim, kalojmë në votim në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Fillojmë me shqyrtimin e çdo pike të tij.

Atëherë me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Komisioni Rregullator vendos:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.

Kolegë, ka diçka? Votojmë pikën 1!

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga vendi i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023. Ka diçka kolegë? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 2.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga vendi i numërimit të votave, në ambientet e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të Komisionit Rregullator. Lidhur me pikën 3, kemi diçka? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 3!

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.


***Kush është dakord kolegë?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit, edhe njëherë kolegë votën tuaj!

***Kush është dakord?***


***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

**Vendim nr. 29**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



18.08.2023  
Ora 11:14

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ M. Koja, E. Dushallari

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: S’ka prezent

**Znj. I. Nano:** Kalojmë në projektvendimin e dytë “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Zonja Koja ju lutem!

**Znj. M. Koja:** Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”, vjen si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëpërmjet

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

këtij projektvendimi, propozojmë përdorimin e PEI-it për identifikimin e zgjedhësve në çdo qendër votimi për të kryer identifikimin e tyre në kuadër të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës. Për sa më lart propozojmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Koja! Në parim kemi diçka për projektvendimin? Jo! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1.Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, procesi i identifikimit të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjitha qendrat e votimit.

Lidhur me pikën 1, kemi diçka? Kalojmë në votimin e pikës 1!

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.18.08.2023*

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit, kolegë!

***Kush është dakord?***


***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Në fakt nuk kemi çështje tjetër për të shqyrtuar, meqenëse sapo i miratuam këto dy projektvendime. Unë kam vetëm një merak, sepse ne si Komision Rregullator kujdesemi që jo vetëm të miratojmë akte, por kujdesemi deri për zbatimin e tyre në frymë dhe në gërmë. Meqenëse kemi zotin Dushallari një nga zyrtarët e ngarkuar për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik, do të doja t'i bëja dy pyetje. Që nga fillimi i zbatimit të projektit të identifikimit elektronik në territorin e Bashkisë Kukës janë zhvilluar dy palë zgjedhje. Kemi zgjedhjet e vitit 2021 për kuvendin, kemi dhe zgjedhjet e 14 majit. Janë venë re problematika lidhur me funksionimin e paisjeve të identifikimit elektronik në qendrat e votimit që i përkasin Bashkisë Kukës?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





**Z. E. Dushallari:** Jo në mënyrë të veçantë.

**Znj. I. Nano:** Pra kanë funksionuar 100%?

**Z. E. Dushallari:** Pak a shumë po.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Kështu që, për të parandaluar çdo problematikë të mundshme, unë do të doja t'i kushtonim vëmendje Bashkisë Kukës në këtë rast, që të mos kemi problematikat që u shfaqën në 14 maj, përse i përket përdorimit të paisjes elektronike të identifikimit, faleminderit!

Meqenëse nuk kemi diçka tjetër në rendin e ditës, apo jashtë rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendim nr. 30**